

V E N D I M
Nr. 37, datë 26.3.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Hilmi Dakli,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtare e “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datat 16.12.1998 dhe 16.2.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.81/6 Akti që i përket :

KËRKUES: ZEF MALÇI, i përfaqësuar nga avokat Kirov Babliku.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

4. PELLAZG FUSHA, i përfaqësuar nga avokat Arben Vani.

5. KESHILLI I RRETHIT KURBIN, në mungesë.

96KOMUNA MILOT, në mungesë.

O B J E K T I :

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.542, datë 26.2.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesi ka parashtruar si shkak ligjor për antikushtetutshmërinë e vendimit të kolegjit civil, cënimin e parimit për një gjykim të drejtë sipas nenit 40 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993, sepse nuk është vënë në dijeni për rekursin që ka ushtruar pala tjetër dhe për rrjedhim i është mohuar e drejta për të qenë i pranishëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Kasacionit.

Si shkak tjetër ai parashtron tejkalimin e kompetencave nga kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, i cili e ka gjykuar çështjen në fakt.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të palës kërkuese, të subjektit të interesuar Pellazg Fusha dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Sipas nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, vendos përfundimisht lidhur me ankesat e individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Mbi këtë bazë, në objektin e shqyrtimit në Gjykatën Kushtetuese hyjnë dhe ato kërkesa që kanë të bëjnë me çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Gjatë kohës që kjo çështje shqyrtohej në Gjykatën Kushtetuese, me ligj u krijuan mjete të tjera për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Kështu, sipas nenit 5 të ligjit nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, kundër vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit si dhe vendimeve të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, palët kanë të drejtë që për shkaqet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, të bëjnë rekurs në Kolegjet e Bashkuara brenda 3 vjetëve nga marrja formë të prerë e vendimit.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji më datë 26.1.1999, shqyrtimi i kësaj çështje nuk është në

juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, sepse nuk është përdorur akoma mjeti i fundit ligjor nga pala e interesuar, rekursi në Gjykatën e Lartë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese, e cila garanton respektimin e Kushtetutës, detyrohet të zbatojë nenin 131 shkronja “f” të saj, duke i dhënë mundësinë kërkuarit që të konsumojë edhe këtë mjet ligjor për mbrojtjen e të drejtave të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 133 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, njëzëri,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 26.3.1999

Nr. 81/6 i regjistrit themeltar

Nr. 37 i vendimit.